



Pranuar / Dorezuar Primjeno / Predato Received / Delivered	05.10.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org. / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPYSAK	6415/2023		1/6



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.Nr.1102/2023

**Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** në përbërje nga: Arditë Haxhnikaj Demi, kryetare; Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë; me Sabile Avdyli, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, si procesmbajtëse, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1102/2023, të datës 22.08.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit Nr.01/2023, të datës 17.08.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "*kontestim konkursi*", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.6; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 04.10.2023, njëzëri mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Shfuqizohet** Vendimi Nr.01/2023, i datës 17.08.2023, i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ndërsa, lënda kthehet **në ri-shqyrtim dhe rivendosje**, të organi i njëjtë.
- II. Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Drejtori i Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën I të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- III. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Ankuesi, (me tej referuar ankuesi), me datë 22.08.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjen

A.nr.1102/2023, kundër Vendimit Nr.01/2023, të datës 17.08.2023, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, Ministria e Punëve të Brendshme, me pretendimin së Konkursi me numër reference: RN00011994, për emrin e grupit “Specialist të Përgjithshëm të Shkencave Politike”, është përcjell me shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin e Karrierës në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ( *këtu e tutje Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 28.08.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ndërsa, kjo e fundit, me datë 06.09.2023, ka përcjell shkresat referuar çështjes në shqyrtim dhe vendosje.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 5769/2023 të datës 22.08.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për qasje në dokumente publike të datës 18.08.2023 të parashtruar nga ankuesi në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit; Ankesën e datës 11.08.2023 të parashtruar nga ankuesi në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Vendimin me numër 01/2023 të datës 17.08.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; E-mailin e datës 18.08.2023 të dërguar nga për E-mailin e datës 18.08.2023 të dërguar nga për Konkursin e shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme me numër reference RN00011994 të datës 03.07.2023 për emrin e grupit Specialistë i përgjithshëm i shkencave politike, për pozitën Zyrtar i misionit diplomatik; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 28.08.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës drejtuar Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-MPB; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1102/2023 të datës 06.09.2023, nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-MPB për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 03/2023 të datës 11.08.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-MPB; Vendimin me numër 05/142 të datës 10.05.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Listën e aplikantëve të aprovuar dhe të refuzuar; Njoftimin e datës 11.08.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-MPB; Njoftimin e datës 17.08.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-MPB; Aplikacionin e datës 02.08.2023 të kandidatit së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; Certifikatën me numër regjistrimi 38099 të Masterit në Shkenca të Administratës Publike të datës lëshuar nga Universiteti i Kalabrisë për për periudhën 23.04.2013-29.04.2013; Vendimin me numër reference 6/4-1149 të datës 29.07.2019 të lëshuar nga Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Diplomën me numër 330/0709 të datës 17.07.2009 të lëshuar nga Kolegji Universitar “FAMA”- Fakulteti i Shkencave Politike- Bachelor i Diplomacisë për Certifikatën e datës 22.11.2022 për arritjet në kuadër të qeverisjes së mir; Certifikatën e pjesëmarrjes së datës 02-09-04.2022 të lëshuar nga “ Reggio Children” për Certifikatën e pjesëmarrjes të lëshuar nga “Usaid” për Certifikatën e pjesëmarrjes së datës 22-24.10.2018 të lëshuar nga “Kosovar Civil Society Foundation Executive Program” për Certifikatën e pjesëmarrjes së datës 08-09.12.2017 të lëshuar nga “Tech Camp Kosovo” për Certifikatën e pjesëmarrjes të muajit Dhjetor 2016 të lëshuar nga “OSCE” për Certifikatën e pjesëmarrjes të muajit Mars 2017 të lëshuar nga “USAID” për Certifikatën e njohjes dhe vlerësimit të datës 29.04.-07.05.2016 të lëshuar nga “ The International Visitor’s Council of Columbus, Ohio” për Certifikatën e njohjes të datës nga 13.05.2016 të lëshuar nga “Open World” për Certifikatën e pjesëmarrjes me numër 10404/15 të datës 12.11.2015 të lëshuar nga “UN-Habitat Kosovo” për

Certifikatën e përfundimit të datës 30.03.2018 të lëshuar nga “International Center on Nonviolent Conflict” për Certifikatën e muajit Dhjetor 2014 të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe “D&D” për Certifikatën e pjesëmarrjes të datës 25.11.2014 të lëshuar nga “KCSF” për Certifikatë e pjesëmarrjes për periudhën 28.03.-11.09.2012 të lëshuar nga Fakulteti i Shkencave Politike të Universitetit të Kalabrisë për Certifikatën e periudhës 14.07.-01.08.2008 të Universitetit të Prishtinës për Vërtetimin me 02 nr.152-3130/09 të datës 12.08.2008 të Zyrës së Personelit të Komunës së Klinës; Certifikatën e muajit Dhjetor 2015 të lëshuar nga “Friedrich Ebert Stigung in Prishtina për Vërtetimin e datës 29.07.2009 të lëshuar nga ItalFor/Gsa për Letër referencën e datës 01.06.2019 të lëshuar nga “Fol” për Letër referencën e datës 01.11.2017 të lëshuar nga “KOHA” për Vendimin e datës 31.08.2018 të lëshuar nga “KUND 16” për Letër referencën të datës 01.06.2019 të lëshuar nga “FOL” për Letër verifikimin e datës 26.08.2020 të lëshuar nga “Pro Open”; Marrëveshjen e datës 28.09.2020 të lidhur mes E.R dhe CILC; Kontratën e punës për punë dhe detyra specifike të datës 08.09.2021 të lidhur mes E.R dhe Regio Terzo Mondo RTM; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 26.04.2023 të lëshuar nga Sistemi qendror i evidencës penale të Kosovës për Pasqyrën e llogarisë së trustit të për periudhën 26.12.2006-12.07.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat e marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji ka gjetur se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (me tej referuar DMZP), Ministria e Punëve të Brendshme, më datë 03.07.2023, ka shpallur në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), Konkursin për praninë, me numër reference RN00011994, për emrin e grupit “Specialistë të Përgjithshëm të Shkencave Politike” lidhur me vendin e punës “Zyrtar i Misionit Diplomatik” në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Klasa profesional 2, numri i kërkuar dy (2) pozita.

Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 24.07.2023 deri me datën 03.08.2023, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi sipas aplikacionit me numër kodit RAN00011994, të datës 02.08.2023.

Në fazën e shqyrtimit paraprak, njësia përgjegjëse në këtë rast DMZP-ja, përmes Vendimit Nr.03/2023, të datës 11.08.2023, ka refuzuar aplikacionin e ankuesit, për shkak se i njëjti nuk ka ofruar vet deklaratë se nuk ka masë disiplinore në fuqi për largim nga pozita e zyrtarit publikë, në rastet kur përvoja e punës është deklaruar në sektorin privat brenda apo jashtë vendit, në një OJQ brenda apo jashtë vendit apo angazhimi nga i cili rrjedhë përvoja e punës është ndonjë formë e marrëdhënies kontraktuale që nuk nënkupton marrëdhënie pune.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimit Nr.03/2023, të datës 11.08.2023, për refuzimin e aplikacionit me numër kodit RAN00011994, parashtron ankesë të brendshme pranë Njesisë Përgjegjëse, e cila me Vendimin Nr.01/2023, të datës 17.08.2023, ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.

Ankuesi, brenda afatit ligjor dhe në mbështetje të nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për zyrtaret Publik parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimin se Konkursi me numër reference: RN00011994, për emrin e grupit “Specialist të Përgjithshëm të Shkencave Politike”, është përcjell me shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114

për Zyratë PubliK dhe Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin e Karrierës në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji i Këshillit në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore fillimisht analizoj Konkursin për pranim për emrin e grupit *Specialistë të Përgjithshëm të Shkencave Politike*, respektivisht pozitën *Zyrtar i Misionit Diplomatik* në Zyrën e Sekretarit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me numër reference RN00011994, dhe për pasojë konstatoi se si kritere formale për pozitën përkatëse të punës kanë qenë:

**Arsimi:** *Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve në fushat: Shkenca Politike/Administratë Publike/Politika Sociale/Juridik;*

**Njohja e gjuhës italian në nivelin e C1 – C2 (obliguar).** *Njohja e gjuhës italiane dëshkohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar, ose diplomë/certifikatë mbi përfundimin e studimeve universitare në cilindo nivel të studimeve, të kryera në këtë gjuhë (italiane). Diploma/certifikata e tillë duhet të jetë në gjuhën italiane ndërsa domosdoshmerisht kërkohet akti i nostrifikimit.*

**Përvoja e punës e kërkuar:** *Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Ndërsa, lidhur me dokumentacionin për aplikim, në pikën 7 të Konkursit si dokumente të kërkuar janë vendosur:

- *Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimin apo aktin që dëshmon se diploma e marrë jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit;*
- *Kopjet e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkëngjitet së paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim: pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale (vërejtje: nuk vlenë vetëm vërtetimi dhe apo vetëm dokumenti mbështetës, është i nevojshëm ngarkimi në sistem i të dy llojeve të dokumenteve: vërtetimi si dëshmi kryesore dhe njëra nga pasqyrat si dëshmi mbështetëse);*
- *Kopje e dëshmisë së njohjes së gjuhës italiane. Njohja e gjuhës italiane dëshkohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar, ose diplomë/certifikatë mbi përfundimin e studimeve universitare në cilindo nivel të studimeve, të kryera në këtë gjuhë (italiane). Diploma/certifikata e tillë duhet të jetë në gjuhën italiane ndërsa domosdoshmerisht kërkohet akti i nostrifikimit.*
- *Kopjet e dëshmisë së trajnimeve të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit. Njëra nga këto dokumente është e mjaftueshme;*
- *Dëshmi përkatëse se kandidati/ja ka zotësi të plotë për të vepruar (prezantohet nga kandidati/ja nëse ai/ajo përzgjidhet për emërim pas përfundimit të vlerësimit dhe në përputhje me rezultatin e arritur);*
- *Dëshmi mjekësore se kandidati/ja është në gjendje të mirë shëndetësore për të kryerjen e detyrës (prezantohet nëse kandidati/ja përzgjidhet për emërim. Dëshmia duhet të jetë jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj);*
- *Certifikatë/vërtetim nga Gjykata ose nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të cilin dëshkohet se nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit;*
- *Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojën e kërkuar e punës, është në sektorin publik, atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati/ja me të cilin dëshkohet se ai/ajo nuk*



*ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L – 114 për Zyrtarët Publik.*

*- Nëse përvoja e punës e deklaruar është në: sektorin privat brenda apo jashtë vendit, në një OJQ brenda apo jashtë vendit apo angazhimi nga i cili rrjedhë përvoja e punës është ndonjë formë e marrëdhënies kontraktuale që nuk nënkupton marrëdhënie pune, atëherë është i nevojshëm një vete deklarim i nënshkruar se ai/ajo, nuk ka nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L – 114 për Zyrtarët Publik.*

Andaj, Kolegji i Këshillit nga analizimi i kriterëve dhe kërkesave të përcaktuar me konkursin me numër reference RN00011994 si dhe vendimit të kontestuar me ankesë, ka konstatuar së Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publike, nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike me rastin e refuzimit të aplikacionit të ankuesit si dhe refuzimit të ankesës së ankuesit të ushtruar kundër refuzimit të aplikacionit, duke zbatuar në mënyrë jo të drejtë dispozitat materiale në fuqi, sepse, njësia përgjegjëse si shkak të vetëm të refuzimit të aplikacionit, thekson mungesën e mos dorëzimit të vet deklaratës se ankuesit se i njëjti nuk ka masë disiplinore në fuqi për largim nga pozita e zyrtarit publikë, në rastet kur përvoja e punës është deklaruar në sektorin privat brenda apo jashtë vendit, në një OJQ brenda apo jashtë vendit apo angazhimi nga i cili rrjedhë përvoja e punës është ndonjë formë e marrëdhënies kontraktual, ndërsa, njësia përgjegjëse ka dështuar që të vërtetoj edhe dëshmitë tjera të kërkuara sipas klauzolës nr.7 të konkursi, siç janë dëshmia mjekësore për gjendjen shëndetësore dhe dëshmia e zotësisë për të vepruar, duke mos dhënë kurrfarë arsytimi pse nuk janë të aplikueshme këto dokumente në rastin konkret.

Ndërlidhur me konstatimin si me sipër, Kolegji bazuar në dëshmitë që posedon sipas ankesës së ankuesit A.nr.853/2023të datës 15.06.2023, ka konstatuar së Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik lidhur me pozitën e njëjtë të punës, ka aplikuar kriterë formale të ndryshme duke zbatuar standarde jo të njëjta të vendimmarjes, rrjedhimisht sipas Konkursit me numër reference RN00011411 për emrin e grupit “*Specialistë të Përgjithshëm të Shkencave Politike-Zyrtar i Misionit Diplomatik, i shpallur me datë 27.04.2023*, në të cilin kishte aplikuar edhe ankuesi, si kërkesa për dokumentacion ishin vendosur: *Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimin për diplomat e marra jashtë vendit; ° Kopjet e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkëngjitet së paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim: pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale; ° Kopjet e dëshmisë së trajnimeve; ° Kopjet e dëshmisë së njohjes së gjuhës ITALIANE. Njohja e gjuhës ITALIANE, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime universitare të kryera në këtë gjuhë ° Dëshmi përkatëse se kandidati/ja ka zotësi të plotë për të vepruar; ° Dëshmi mjekësore se kandidati/ja është në gjendje të mirë shëndetësore për të kryerjen e detyrës; ° Certifikatë/vërtetim nga Gjykata ose nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të cilin dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit; ° Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojën e kërkuar e punës, është në sektorin publik, atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati/ja me të cilin dëshmohet se ai/ajo nuk gjendet në kushtet parashikuara në nenin 8 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.6) të Ligjit Nr.06/L – 114 për Zyrtarët Publik, Pra, DMZP-ja sipas konkursit me numër reference RN00011411, nuk kishte vendosur si kërkesë për dokumentacion vet deklarimin se kandidati nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, ndërsa ankuesit si kandidat në këtë konkurs, me Vendimin Nr.01/2023 të datës 30.05.2023 të DMZP-së, i ishte mohuar e drejta e*

vazhdimit të mëtejme në këtë procedurë të pranimit, me arsyetimin se ankuesi nuk ka dorëzuar dëshmi përkatëse që ka zotësi për të vepruar me afat ashtu siç është kërkuar në konkursin me numër reference RN00011411 gjegjësisht dëshmia e bashkangjitur është me afat të skaduar. Kurse, në Konkursin me numër reference RN00011994, DMZ-ja aplikon kriter shtese gjegjësisht vet deklarimin nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, dhe se përkundër faktit se kishte përcaktuar kërkesën për dëshmi lidhur me zotësinë e veprimit dhe dëshmi për gjendjen shëndetësore, në këtë rast nuk ishte lëshuar në këto kërkesa, rrethana këto që ven në pah zbatim jo të njëjtë të dispozitave procedurale dhe materiale nga njësia përgjegjëse për raste të njëjta, dhe që kanë për pasojë trajtim jo të drejtë të ankuesit.

Meqenëse, vendimi i atakuar përmban të meta të tillë të cilat pamundësojnë vendosjen meritore lidhur me këtë çështje administrative, Kolegji i Këshillit, vlerëson që lënda duhet të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, i cili siç është përcaktuar në dispozitivin e këtij vendimi është i detyruar që në riprocedurë të rishqyrtoj çështjen e ankuesit, duke marr për bazë vërejtjet dhe pikëpamjet juridikë të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, ndërsa, me rastin e vendosjes të nxjerrë akt administrativ duke e arsyetuar të njëjtin siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative dhe në mbështetje të ligjit material.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.1102/2023

Sabile AVDYLI

*Sabile Avdyli*  
Procesmbajtëse



### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të MPB
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/MPB;
- Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit-DMZP-MPB; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.